Amvisëritë ballafaqohen me “varfërinë energjetike”

Varfëria energjetike është një term relativisht i ri posaçërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Me varfëri energjetike nënkuptojmë mungesën e ngrohjes së rregullt në shtëpitë. Për të ilustruar në mënyrë më të qartë, varfëria energjetike përshkruhet si një gjendje në të cilën amvisëritë jetojnë me ngrohje të përshtatshme në shtëpitë e tyre, brenda së cilës temperatura mesatare duhet të jetë nën kufirin e përcaktuar biologjikisht prej 21 gradë celicius e nevojshme për mirëmbajtjen e komforit dhe shëndetit, ose që shkalla e ngrohtësisë në shtëpi të jetë më e ulët nga minimumi subjektiv që tmundëson një individ të zhvilloj jetën e përditshme në mënyrë të drejtë.

“Varfëria energjetike ose e lëndëve djegëse në Ballkanin Perëndimor nuk është mungesa e qasjes në infrastrukturë, por vështirësia për mirëmbajtjen e ngrohtësisë së mjaftueshme me çmim adekuat”

AHMET OSMANI ZAMAN

Organizata joqeveritare “Analitika” është themeluar në vitin 2005 dhe bën hulumtime të ndryshme në fushën e shpenzimeve energjetike. Gjithashtu bën edhe analiza të politikave të qeverisë, se si sillen ligjet dhe në çfarë mënyre po zbatohen ato, si dhe formulon propozime deri tek vendimmarrësit. Një ndër hulumtimet e bëra është edhe programi për kapacitetet energjetike në vend. Projektet e realizuara në këtë drejtim janë: politika dhe efikasitetet energjetike, burimet rinovuese të energjisë, gazifikimi, pazari i nxehjes etj. Ligji për energjetikë në RM disa herë ka pësuar ndryshime. Arsyeja e ndryshimeve ka qenë përputhja me kërkesat e BE-së, si shtet kandidat. Ndryshimi i fundit, gjegjësisht paketa e 3-të në energjetikë është një kombinim i disa rregullativave dhe direktivave nga ana e BE-së që kanë të bëjnë me përmirësimin e pazarit energjetik rajonal, me interes edhe për Maqedoninë. Në një studim të Komisionit rregullator të energjetikës thuhet se Maqedonia dhe Shqipëria kanë çmimin më të lartë të rrymës elektrike për një kilovatorë në rajon. Rritja e çmimit vështirë po përballohet nga qytetarët.



Bisedë me Ana Stoillkovska, hulumtuese në fushën energjetike në organizatën joqeveritare **“Analitika”**

Në Maqedoni, në vazhdimësi, ka rritje të çmimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore, që me vështirësi po përballohet nga qytetarët që janë të prekur nga kriza ekonomike. Për shkak të çmimeve të larta të ngrohjes dhe energjisë elektrike, autoritetet shtojnë apelet për racionalizim të energjisë përmes përdorimit të mjeteve alternative, siç janë llambat kursyese të energjisë elektrike apo panelet diellore. Qytetarët në Maqedoni shumë pak shfrytëzojnë alternativa të ndryshme energjetike, siç janë gazi natyror, energjia solare apo kolektorë të ndryshëm diellor.

Çfarë përmban paketa e 3-të e ndryshimeve në energjetikë?

Duke qenë të vetëdijshëm për problemet e përjetuara në të kaluarën, tentohet që të minimizohen dhe të anashkalohen problemet. Mbi të gjitha fokusohen në përmirësimin e tregut energjetik mes shteteve, me qëllim që në të ardhmen të ketë më shumë pavarësi të komisioneve rregullatorë. Sepse komisioni ynë rregullator është një institucion i ri, i themeluar për të kontrolluar çmimin në treg. Komisioni rregullator duhet të jetë një institucion i pavarur, mirëpo jo vetëm ky institucion, por edhe të tjerët nuk janë aq të fuqishëm saqë kanë nevojë. Ky institucion duhet ta rregullojë, apo t'i kontrollojë kompanitë që furnizojnë me energji elektrike, akumulojnë dhe që e shpërndajnë të njëjtën.





Maqedonia bën furnizimin e pjesës më të madhe të energjisë elektrike nga shtetet fqinje, siç është Bullgaria dhe Serbia. Nëse merret parasysh bilanci i energjisë së importuar nga viti 2010 deri më 2012, do të vërejmë se Maqedonia ka prodhuar pak energji vetëm në vitin 2012, kurse gjithnjë e më shumë po rritet niveli i energjisë të cilën e importon nga jashtë. Në bilancin e fundit tregohet se varësia e Maqedonisë për energjinë elektrike, përfshirë këtu të gjitha llojet e furnizimit energjetik, në vitin 2012 ka qenë 48.8%.

Maqedonia varet nga importi i energjisë elektrike

Nëse hedhim një sy për atë se çfarë resursesh të energjisë posedojmë në vendin tonë, kur dihet se gaz natyral nuk kemi, naftë nuk kemi, andaj këto lloje të energjisë duhet importuar nga jashtë. Një pjesë të rrymës elektrike prodhojmë, por kjo nuk mjafton, andaj importohet pjesa shtesë. Strategjia e energjetikës në Maqedoni tregon se në 20 vitet e ardhshme do të kemi gjendje kritike për sa i përket energjetikës. Gjëja e parë që duhet bërë në këtë drejtim është të përmirësohet efikasiteti në energji. Kjo mund të bëhet duke marrë disa masa, si p.sh. përmirësimi i termocentraleve dhe i hidrocentraleve, duke përdorur teknologji nga më të rejat. Gjithashtu të merren edhe masa nga ana e shfrytëzuesve të rrymës elektrike. Është shumë e rëndësishme që të kemi edhe një miks-energjetik, për të pasur resurse të më shumë llojeve të energjisë, siç është gazifikimi dhe resurse të tjera.


Pse kemi rritje të vazhdueshme në çmimin e rrymës elektrike?

Kjo ndodh ngaqë energjinë elektrike që e përdorim aktualisht është e subvencionuar nga ana e shtetit. Çmimet mjaft u rritën deri tani, por akoma nuk ka një çmim në përputhje me kërkesat e tregut. Kur nuk është çmimi i kërkuar, atëherë vetë prodhuesit e energjisë janë në humbje, gjegjësisht nuk kanë financa të mjaftueshme për të investuar. Një nga arsyet për sjelljen e ligjit të ri për liberalizim është edhe tërheqja e subvencionimit nga ana e shtetit. Andaj, fillimisht kjo do të çojë në rritje të çmimeve që mund të zgjasë disa vite.



Nuk do të lejojmë të ketë rritje të shpeshta në çmimin e rrymës elektrike nëpër amvisëritë. Mirëpo është fakt se çmimi i rrymsë elektrike do të pësoj rritje edhe në vitet e ardhshme. (Intervista e Dimitar Petrov, kryetar i Komisionit Rregullator për Energjetikë, e realizuar për të përditshmen Nova Makedonija më 22 Mars 2014)

Deri më 1 janar të vitit 2015 duhet të bëhet liberalizimi i plotë i energjisë



Maqedonia ashtu siç edhe shtetet e mëparshme komuniste ka një sistem të centralizuar të pajisjes dhe distribuimit të energjisë. Tani synohet që të vendoset konkurrencë në treg. Ajo çka BE-ja insiston të bëjë, është ndarja e funksioneve në energjetikë. Që do të thotë se duhet të dallohen ndërmarrja që prodhon energji elektrike, nga ajo që pajiset me energji elektrike dhe që distribuon energji elektrike. Maqedonia deri më 1 janar të vitit 2015 duhet të bëjë liberalizim e plotë të energjisë.

Çfarë do të sjell liberalizimi i energjisë?

Konkurrenca më e madhe, natyrisht që ofron kualitet më të lartë në shërbime dhe çmim më të ulët. Energjia nuk njeh kufij, andaj vendi ynë si një shtet i vogël me një pazar të vogël, do t'i hap kufijtë me tregjet e shteteve të tjera. Hapja e pazarit sjell konkurrencë, kurse konkurrenca sjell kualitet dhe leverdi në çmime. Por kjo do të bëhet në faza. Zakonisht kur bëhet liberalizim i tregut, në fillim çmimet rriten dhe më vonë ulen me kohë.

Shteti ka një "varfëri energjetike" deri në 60 për qind të nevojave

Çfarë nënkuptojmë me termin "varfëri energjetike"? Nëse një amvisëri nuk posedon brenda në shtëpi një temperaturë relative prej 21 gradësh celsius, atëherë bëhet fjalë për një varfëri energjetike, aq më shumë kur në vendin tonë afër 60% e amvisërive e kanë këtë problem. Të tillë nuk janë vetëm familjet e varfra me të ardhura të ulëta, por edhe ato me të ardhura më të mira, që jetojnë në shtëpi private dhe nuk u mjaftojnë paratë për ta rinovuar shtëpinë, të montojnë dritare të reja, nxehen me drunj dhe jo me priketa, me mjete të vjetruara apo tubohen në një dhomë për t'u nxehur. Profesori universitar Stefan Buzharovski, në hulumtimin e tij kishte ardhur në përfundim se 60% e amvisërive në Maqedoni janë me varfëri energjetike, andaj kujdes shumë më të madh duhet të kemi për shtresën sociale.

Maqedonia posedon potenciale të mëdha për energji rinovuese

Në kuadër të resurseve të rinovuara të energjisë elektrike, Maqedonia i përfshinë centralet elektrike, të mëdha dhe të vogla, kurse studimet e reja më progresive, ndërsa BE-ja ato të mëdhatë nuk i konsideron si rinovuese, por i konsideron ato që prodhojnë energji elektrike përmes ajrit, diellit, që përfitohet me biomasë, biogaz (gazifikimi) dhe në mënyrë gjeotermale. Hulumtimi për resurse rinovuese të energjisë në Maqedoni tregon se vendi ka një potencial të madh të resurseve të energjisë rinovuese, gjegjësisht nga potencialet që i posedon mund të prodhojë energji elektrike me kapacitet prej 3795 GW orë në vit dhe energji nxehjeje deri në 1565 GW orë në vit.

Pse ka dështim të madh të tenderëve në vend?

Arsyeja për dështimin e një numër të madh të tenderëve për ndërtimin e centraleve elektrike duhet të kërkohet në mungesën e investuesve përkatës. Sepse, investimet e tilla kërkojnë një kapital shumë të madh dhe, nga ana tjetër, ndërtimi duhet të bëhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ngaqë ndërtimet e tilla kanë edhe një rrezik të tillë, sepse mund ta dëmtojnë mjedisin jetësor.

Përdorimi i energjisë solare (diellore) mundësi për të kursyer para

Nëse merret parasysh bilanci se ku harxhojnë më së shumti energji amvisëritë, do të shohim se një pjesë e madhe e energjisë elektrike shkon në nxehje, kurse pjesa tjetër në aparatet e amvisërisë dhe në nxehje të ujit. Kështu që, në përdorimin e një kolektori (prodhim të rrymës përmes paneleve diellore), parashikimi i ministrisë së ekonomisë ishte se bëhet kursim i energjisë deri në 300 euro në vit dhe, gjithashtu, sigurohet ujë të nxehtë gjatë gjithë kohës. Kolektorët janë shumë të leverdishëm për përdorim, ngaqë nuk ka nevojë vetëm për diell që ato të funksionojnë, por mjafton të ketë rrezatim të diellit. Maqedonia, pas Spanjës dhe Greqisë, ka potencial më të madh për përdorim të energjisë solare.

Subvencionimi i shtetit për energjinë solare nuk mjafton

Kostoja e shtrenjtë e përdorimit të energjisë diellore në vend të energjisë elektrike, u pamundëson qytetarëve që të orientohen në përdorimin e energjisë solare edhe përkundër ekzistimit të potencialit të madh prej 240- 270 ditë me diell. Për një pjesë të madhe të amvisërive, harxhimet mujore për energjinë, pas ushqimit, paraqiten si rëndues më të mëdhenj të buxhetit familjar. Maqedonia ka resurse të limituara energjetike, që rrisin edhe vartësinë prej importit të rrymës, kurse në të ardhmen më shumë duhet të orientohet si në kursimin e energjisë, ashtu edhe në shfrytëzimin më të madh të burimeve rinovuese të energjisë. Ekspertët gjermanë, të cilët e kanë vlerësuar tregun vendor energjetik, shprehen se në Maqedoni shumë pak shfrytëzohen burimet alternative të energjisë, me përjashtim të hidro-energjisë. Prandaj, së pari duhet të mbështetet më shumë shfrytëzimi më i madh i energjisë solare për fitimin e ujit të ngrohtë, ndërsa si opsion tjetër më i komplikuar mbetet shfrytëzimi i qelive foto-voltazhe për prodhimin e rrymës. Maqedonia ka strategji për zhvillimin e burimeve të rinovuara që parashikon deri në vitin 2020 të ndërtohen 10-30 MË sisteme foto-voltazh për prodhimin e 14- 42 GW energji elektrike në vit.9

Decentralizimi i prodhimit të energjisë elektrike, një zgjidhje e mirë

Decentralizimi do të thotë, të prodhohet energji elektrike lokale dhe harxhimi të bëhet në mënyrë lokale, që është një metodë shumë efikase dhe që nuk sjell harxhime të mëdha financiare në ndërtimin e centraleve të mëdha elektrike. Momentalisht nuk ka plane të tilla, por në të ardhmen një gjë e tillë do t'ia lehtësonte shumë punën edhe kapaciteteve të energjisë elektrike, edhe të shtetit, por edhe të familjeve. Në dukje është edhe ndërtimi i pajisjeve që do të shfrytëzojnë lëvizjen e ajrit (erës) për prodhimin e energjisë, sidomos në lindje të Maqedonisë. Në të kaluar u bënë edhe disa hulumtime në këtë drejtim. Mendoj se parashikimet e ELEM-it, që është i kyçur në këtë projekt, thonë se energjitë rinovuese do të sjellin rritje prej 2% në prodhimin final të harxhimit të resurseve të energjisë elektrike.

PËRDORIMI I NXEHJES QENDRORE NDIHMON NË RRITJEN E KAPACITETEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE



Duhet të hiqet monopoli në nxehjen qendrore

Një nga mënyrat për më shumë kapacitet të energjisë elektrike është, gjithsesi, braktisja e nxehjes me rrymë elektrike, ngaqë nxehja harxhon sasi të mëdha të energjisë elektrike. Një ndër problemet më të mëdha është edhe rregullimi i tregut për nxehje qendrore. Nëse ky problem zgjidhet, shumë probleme të tjera përcjellëse do të zgjidhen. Momentalisht, 10% e qytetarëve të Maqedonisë përdorin nxehje qendrore, kryesisht në qytetin e Shkupit, varësisht ku ka infrastrukturë apo sistem të nxehjes. Mirëpo, fatkeqësisht, një numër i madh i qytetarëve, për shkak të çmimeve jo të volitshme, janë duke u shkyçur nga nxehja qendrore, që është një problem shtesë. 90% e qytetarëve nxehet duke përdorur alternativa të tjera, siç është nxehje me dru ose me rrymë elektrike, që sjell një humbje të madhe të energjisë elektrike. Para dy viteve, kur bënte dimër i ftohtë, për shkak të shfrytëzimit maksimal të energjisë elektrike, kishte shkycje të përkohshme të dritave në rrugët publike në tërë qytetin e Shkupit.

Nxehja qendrore definitivisht duhet të ketë alternativa të tjera. Duhet të merren masa përkatëse në këtë drejtim. Tani për tani nuk merret parasysh sasia e harxhimit, por hapësira me metra katrorë në krye të banorit, kurse për këtë duhet të vendosen orëmatës. Para se të vinte "Balkan Energy Group", drejtues i ndërmarrjes për nxehje ishte "Toplifikacija". Ajo i caktonte çmimet sipas pazarit të nxehjes. Këtu rol më të madh ka Komisioni Rregullator dhe institucionet për heqjen e monopolit. Sepse, nxehja qendrore është një monopol dhe patjetër ka nevojë për kontrollim.

Qytetarët duhet të paguajnë aq sa harxhojnë

Fajin më të madh e shoh tek institucionet e sistemit, të cilat duhet të jenë më rigorozë ndaj monopoleve. Çmimet rriten deri në një nivel, nëse disa shkyçen nga nxehja qendrore, që deri-diku mund të kuptohet, mënyra më e mirë do të ishte vendosja e rregullave të qarta. Qytetarët të kenë mundësi të paguajnë aq sa harxhojnë dhe jo të paguajnë edhe shpenzimet e të tjerëve që janë shkyçur apo të paguajë diçka që s'ka shpenzuar. Dua të them se qeveria duhet të bëjë politika nxitëse dhe jo të sjellë situatën deri në shkycje nga nxehja qendrore. Komisioni Rregullator duhet të bëjë kontrolle më të shpeshta dhe më rigoroze, kurse qeveria duhet të sjell alternativa për qytetarët, siç është gazifikimi apo hapjen e tenderëve për hyrjen e kompanive të reja në këtë fushë. Kësisoj do të ishin kompanitë që do të prodhonin energji për nxehje dhe do t'ia shitnin ndërmarrjes "Balkan Energy".

Komuna e Strumicës me sistem gazifikimi

Maqedonia duhet të bëjë një hulumtim se si duhet të rregullohet pazari i nxehjes. Fillimisht duhet të formohet infrastruktura për përdorimin e gazifikimit. Disa komuna këtë e realizuan në mënyrë individuale. Komuna e Strumicës tani më ka përfunduar me realizimin e këtij sistemi, kurse komuna e Karposhit është në fillim të realizimit. Komuna e Strumicës ka mbaruar një pjesë të qytetit me instalimin e rrjetit për gazifikim dhe duke eksportuar gaz natyral të kompresuar me kamionë nga Bullgaria, bëjnë një kursim të madh të rrymës elektrike. Konkretisht, një përfaqësuese nga komuna e Strumicës, në një konferencë, theksoi se për një vit këtu janë përgjysmuar shpenzimet. Z

